VENDIM
Nr.108, datë 28.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Kreu 1.3 zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Kreu 1.5 zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja 1 (kreu 1.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR DHE SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

NR.	**EMËRTIMI**	**PAGA MUJORE**					
		PAGA INDIVIDUALE			**SHTESA E POZICIONIT**		
		1	**2**	**3**	**4**	**5**	
		Paga e grupit (PG)	**Shtesa për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifikim (SHK)**	**Shtesa për pozicion (SHP)**	**Shtesa për kushte pune (SHKP)**	**Totali**
1.	Drejtor dhe kryeinspektor sanitar	10050	2%	0	37000	9000	Nga deri…lekë
2.	Drejtor ekzekutiv	10050	2%	0	37000		Nga deri…lekë
3.	Drejtor	10050	2%	0	25000		Nga deri…lekë
4.	Shef shërbimi i kujdesit parësor; Shef shërbimi	10050	2%	0	18000		Nga deri…lekë

	urgjence; Zëvendësdrejtor						
5.	Shef shërbimi i higjienës; Shef shërbimi i epidemiologjisë	10050	2%	0	18000	9000	Nga deri…lekë
6.	Shef shërbimi stomatologjik	10050	2%	0	18000	3300	Nga deri…lekë
7.	Specialist i lartë në higjienë; Specialist i lartë në epidemiologji	10050	2%	0	16150	7000	Nga deri…lekë
8.	Shef reparti; Përgjegjës poliklinike; Shef kabineti; Shef/përgjegjës laboratori; Përgjegjës dispancerie	10050	2%	0	16150		Nga deri…lekë
9.	Epidemiolog; Higjienist	10050	2%	0	16150	8000	Nga deri…lekë
10.	Inspektor stomatolog	10050	2%	0	16150	1100	Nga deri…lekë
11.	Shef reparti higjiene; Shef reparti epidemiologjie	10050	2%	0	16150	9000	Nga deri…lekë
12.	Mjek; Stomatolog; Inxhinier elektrik; Kimist; Veteriner; Mikrobiolog; Shef sektori; Përgjegjës zyre	10050	2%	0	13800		Nga deri…lekë
13.	Mjek ftizioterapeut; Mjek kirurg; Mjek ortoped; Mjek pneumoftiziatër	10050	2%	0	13800	1100	Nga deri…lekë
14.	Mjek radiolog; Mjek psikiatër; Mjek hematolog; Mjek onkolog	10050	2%	0	13800	1600	Nga deri…lekë
15.	Specialist i lartë	10050	2%	0	12000		Nga deri…lekë
16.	Specialist i lartë promocioni	10050	2%	0	12000	6000	Nga deri…lekë

Lidhja 1 (kreu 1.5)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN

KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE

NR.	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Drejtor	10050	2%	0	59714		Nga deri…lekë
2.	Zëvendësdrejtor	10050	2%	0	49942		Nga deri…lekë
3.	Shef sektori	10050	2%	0	43428		Nga deri…lekë
3.1.	Shef sektori	10050	2%	0	32571		Nga deri…lekë
4.	Farmacist	10050	2%	0	21714	4000	Nga deri…lekë
5.	Analist	10050	2%	0	32571	4000	Nga deri…lekë
6.	Farmacist inspektor për kontrollin farmaceutik	10050	2%	0	32571	5000	Nga deri…lekë
7.	Specialist i lartë	10050	2%	0	16286		Nga deri…lekë